



COURE UROPÉENNE DES DROITS DEL'HOMME
GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTA TË
NJERIUT
SEKSIONI

KATËRVENDIM

PËR PRANUESHMËRINË E

Aplikacioni nr. 43384/05
nga Cecil Stephen WALSH
kundër Mbretërisë së
Bashkuar

Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut (Seksioni katër), në takimin e datës 21 nëntor 2006 si Odë e përbërë nga:

z.J. CASADEVALL, *President*, Sir

Nicolas BRATZA,

z.G. BONELLO, z.

PELLONPÄÄ, z.

K. TRAJA,

z.S. PAVLOVSKI,

z. J. ŠIKUTA gjyqtarë ,

dhe z. T.L. EARLY, *Kryesekretar*,

Duke pasur parasysh aplikacionin e dorëzuar me 15 shtator 2005, pas shqyrtimit kanë vendosur:

FAKTET

A. Rrethanat e rastit

Aplikuesi është një qytetar Irlandez i lindur me 1966 dhe aktualisht vuan dënimin me burg në Burgun HMMaghaberry, Lisburn, në Irlandën Veriore. Ai përfaqësohet nga z. P. Pierce, avokat i cili e ushtron profesionin në Belfast.

Aplikuesi ka një listë të gjatë të veprave penale që fillojnë në shkurt 1980. Këto të dhëna përmbajnë 132 shkelje të rregullave të trafikut, një vepër komploti për vjedhje, katër vepra plaçkitjeje, tetë vjedhje dhe 14 pajisje për vjedhje së bashku me dënime tjera të ndryshme.

Me 13 qershor 2003, aplikuesi, me bashkëpunëtorë tjerë ishte shpallur i pafajshëm për fitim të pronës dhe shërbimeve përmes mashtrimit. Urdhëri për mbajtje të pronës së aplikuesit që mbahej pezull për konfiskim eventual pas dënimit u anulua.

Me 2 korrik 2003, Agjencia për kthim të aseteve ka ftuar aplikuesin për qëllime të procedurave të kthimit. Agjencia e ka kërkuar kthimin e shumës prej 70,250 funtave që i janë paguar avokatit të tij në 2001 për blerje të shtëpisë dhe shumën prej 5,969.10 funtash e ka mbajtur në llogari bankare duke pretenduar se këto ishin të ardhura të veprimeve të paligjshme brenda kontekstit të Aktit për të ardhura nga krimi ("POCA").

Në një dëgjim bashkëbisedues, në emër të aplikuesit u argumentua se procedurat për kthim të aseteve të tij nuk ishin "civile" por penale për nga natyra dhe se aplikohen garancionet e neneve 6 §§ 1 dhe 2 në veçanti për sa i përket standardit të dëshmisë.

Më 1 prill 2004, gjyqtari i Gjykatës së Lartë ka refuzuar pohimet e aplikuesit për çështjen e tij duke pasur parasysh, duke ekzaminuar autoritetin vendor dhe të Strasburgut, se nuk ka pasur ndonjë aktakuzë të përcaktuar në procedurën e kthimit.

Më 26 qershor 2005, Gjykata e Apelit në Irlandën Veriore e ka refuzuar apelin e aplikuesit. Ka gjetur, duke aplikuar kriteret Engel, se në ligjin vendor procedurat janë klasifikuar si civile, duke mos involvuar aktakuzë penale në një mjedis kriminal ose dhënë rëndësi të dhënave kriminale; se qëllimi i procedurave nuk ishte për ta bërë atë të hapur për dënim për një krim specifik përmes burgimit ose një gjobe mirëpo kanë natyrë të kthimit duke kërkuar kështu kthimin e aseteve të fituara përmes veprës penale. Përsa i përket natyrës së ndonjë gjobe, përderisa kthimi i aseteve do të mund të përshkruhej tanimë si masë preventive, gjykata ka konsideruar se edhe nëse procedurat kanë vënë ndonjë gjobë, kjo nuk ishte e mjaftueshme për të klasifikuar procedurën si penale për qëllime të artikullit 6 § 1 të Konventës.

Gjykata ka konkluduar, duke refuzuar argumentet se procedura është penale:

“Thelbi i nenit 6 në dimensionin penal është akuzimi i një personi për kryerje të veprës penale për qëllime të sigurimit të dënimit në aspektin e vënies së sanksionit penal ndaj atij personi. Këto procedura janë qartë dhe shumë më të ndryshme prej atij lloji të aplikimit. Ato nuk e kundërshtojnë atë në aspektin se kërkojnë dënim përtej kthimit të aseteve që ligjërisht nuk i përkasin atij. Si të tilla, përderisa ato do të kenë një ndikim në apeluesin , ato janë procedura in rem. Ato janë dizajnuar për të kthyer të ardhurat e krimit, në vend se të përcaktojnë , në kontekstin e procedurave kriminale, fajësinë për vepër specifike. Efekti kumulativ i testeve në Engel është identifikimi i qartë i tyre si procedura civile”

Me 7 korrik 2005, Dhoma e Lordëve ka refuzuar apelin.

Me 6 korrik 2006, në vendimin rreth aplikacionit për urdhërin e kthimit civil kundër aplikuesit për shumat 70,250 funta që supozohen të jenë paguar për blerje të pronës dhe 5,969.10 funta që aktualisht mbahen në llogari bankare, Gjyqtari i Gjykatës së Lartë ka marrë parasysh dënimet penale të aplikuesit deri në vitin 2003 gjë që ishte një indikacion i qartë për tendencën e tij të kryejë në vepra serioze penale. Ai nuk ka marrë parasysh veprat për të cilat është shfajësuar aplikuesi pasi nuk e ka pasur mundësinë e vlerësimit të cilësisë së dëshmisë së njërit prej dëshmitarëve identifikues dhe përderisa ka shënuar se nuk është ushtruar ndjekje penale që do të pasonte me arrestim të aplikuesit dhe E. për dyshim për plaçkitje, ai nuk e ka marrë në konsideratë se aplikuesi është gjetur në ditën e plaçkitjes në shoqëri të E, i cili kishte me vete disa bankënote të shënuara si konfirmim i relatave të tij kriminale, sikurse edhe dëshmia e zyrtarëve policor për sa i përket shoqërimit të tij me persona që kanë rekorde kriminale. Gjyqtari vazhdoi për të kuptuar rreth aseteve të aplikuesit. Nuk kishte ndonjë dëshmi që do të mbështeste punën e tij si shitës i veturave dhe asnjë të dhënë se ai ka qenë i punësuar tek Irland Revenue. Vetëm vlera të vogla, prej punësimit të supozuar me biznesin e pastrimit (fitimet e të cilit paraqiteshin në kohën e vuajtjes së dënimit me burg) dhe benefiteve shtetërore ishin deklaruar. Ai ka konkluduar se ishte i kënaqur me balancin e probabiliteteve, se aplikuesi ka pasur stil jetësor kriminal duke përfshirë veprimet e pandershme dhe fitimet nga krimi gjithmonë në gatishmëri për dhunë nëse do të ishte e nevojshme. Rekordet e tija kriminale dhe në veçanti dënimi i tij për konspiracion për vjedhje, shoqërimi i tij me kriminelë që kishin historik të ngjashëm të kryerjes së veprave penale së bashku me rrethanat në të cilat ai është arrestuar rishtazi kanë shërbyer për ta bindur atë se krimi ka qenë mjet i tij primar për fitim të fondeve për një numër të viteve. Në këto rrethana ai ishte i kënaqur se shumat të cilat i ka kërkuar Agjencia për kthim paraqisnin pronën e fituar përmes veprave të paligjshme dhe ai në bazë të kësaj ka lëshuar urdhërin për kthim të vlerës së parave të përcaktuar në aplikacion.

Ligji dhe praktika vendore relevante

Sipas Aktit 2002 për të ardhurat nga krimi , aplikacioni mund të jetë dorëzuar në Gjykatën e Lartë për kthim civil të pronës që përfaqëson të ardhura nga “veprimet e paligjshme”

Sipas seksionit 241(1) vepra e paligjshme përcaktohet si:

“Vepra që kryhet në cilëndo pjesë të Mbretërisë së Bashkuar është e paligjshme nëse është e paligjshme sipas Kodit Penal të asaj pjese.”

Seksioni 241(3) siguron që standardi i dëshmisë së veprës së paligjshme të jetë ai i balancit të probabiliteteve.

ANKESAT

Aplikuesi ankohet se procedurat e kthimit hyjnë nën kontekstin kriminal të Nenit 6. Ai ankohet se atij i është mohuar prezumimi i pafajësisë në kundërshtim me Nenin 6 §2 pasi është aplikuar standardi civil e jo ai penal. Ai ankohet se procedurat mund të jenë zhvilluar tërësisht në bazë të dëshmisë në kundërshtim me Nenin 6§3(d); se atij i është vënë gjobë për veprën që është kryer para se në të hyjë POCA në fuqi dhe se kthimi i aseteve të tij nën këto rrethana e shkelë Nenin 1 të Protokolit nr. 1.

LIGJI

1. Aplikuesi ankohet se atij i është mohuar prezumimi i pafajësisë pasi është aplikuar standardi civil i dëshmisë dhe se procedura ka mundur të zhvillohet tërësisht përmes dëshmisë me betim pa dëgjim të dëshmitarëve. Ai apeloj në bazë të Nenit 6§§2 dhe 3(d) të Konventës.

Dispozitat relevante janë si vijon:

“2. Çdokush i akuzuar për kryerje të veprës penale do të supozohet se është i pafajshëm deri sa të dëshmohet fajësia sipas ligjit.

3. Çdokush i akuzuar për kryerje të veprës penale i ka të drejtat vijuese minimale:

...

(d) të pyesë ose të ketë pyetur dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në të njëjtat kushte sikurse dëshmitarët e akuzës ; ...”

Çështja preliminare për të cilën duhet të merret vendimi është nëse procedurat e kthimit kundër aplikuesit kanë përfshirë përcaktimin e aktakuzës penale aq sa do të hynin në proces dispozitat e thirrura më lartë. Gjykata duhet të merr në konsideratë , në këtë kontekst, tri kriteret udhëzuese sipas të cilave është ndërtuar aktakuza : klasifikimi i çështjes në ligjin vendor, natyra e akuzës dhe gjoba të cilën personi është i obliguar ta paguajë ((*Ezeh dhe Connors v. Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nos. 39665/98 dhe 40086/98, § 82, ECHR 2003-X, që citon *Engel dhe të tjerët v. Holandës*, vendimi i 8 qershorit 1976, Seritë A nr.22, pp.34-35, §§82-83). Thuhet, fillimisht, se sipas ligjit vendor, procedurat e kthimit shihen si civile, jo penale. Procedurat mund të jenë nisur pas shfajësimit për vepra specifike penale mirëpo ishin të ndara dhe të veçanta për sa i përket kohës, procedurës dhe përmbajtjes (cf. *Phillips v. Mbretëria e Bashkuar*, nr.41087/98, §§32 dhe 39, BNJKE 2001-VII). Së dyti, gjykatat vendore kanë konsideruar se qëllimi i procedurave nuk ishte ndëshkues ose mbajtës mirëpo ishte kthimi i aseteve të cilat nuk i përkisnin ligjërisht aplikuesit (shih poashtu *Butler*

v. *Mbretërisë së Bashkuar* (dec.), nr. 41661/98, BNjKE 2002-VI. Gjykata poashtu thekson se nuk ka të gjetur mbi fajësinë për vepra specifike dhe se gjyqtari i gjykatës së Lartë gjatë përpilimit të urdhërit ka qenë i kujdesshëm që mos marrë parasysh veprat për të cilat aplikuesi është shfajësuar. Së fundi, urdhëri për kthim nuk ishte ndëshkues për nga natyra, përderisa nuk kishte dyshim se ka përfshirë një shumë të lartë, ajo vlerë parash nuk është determinues për natyrën penale të të ardhurave (shih *Porterv. Mbretërisë së bashkuar*, (dhjet.), nr. 15814/02, 8 korrik 2003, ku aplikuesi është i obliguar të paguajë 33 milionë funta për humbjet financiare të autoritetit lokale gjatë mandatit të tij si lider.

Në vijim, procedurat ishin jashtë kontekstit të Nenit 6 §1 të Konventës dhe kjo pjesë e aplikacionit duhet të refuzohet si *ratione materiae* jo-kompatibile me dispozita të Konventës në pajtim me Nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

2. Aplikuesi është ankuar se legjislacioni për kthimin e aseteve është përcaktuar për rastin e tij në retrospektivë, duke shkelur Nenin 7 (ndalesa e gjobave retrospektive kriminale) dhe Neni 1 i Protokolit nr. 1 (e drejta për të gëzuar pronën) në atë aspekt.

Për sa i përket Nenit 7, Gjykata ka gjetur se procedurat nuk kanë përfshirë përcaktimin e aktakuzës. Kjo dispozitë nuk është e aplikueshme dhe ankesa do të refuzohej si *ratione materiae* jo-kompatibile sipas Nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Për sa i përket Nenit 1 të protokolit nr. 1, Gjykata thekson se aplikuesi nuk ka treguar se është ankuar për ndërhyrjen në të drejta të pronës nën këtë dispozitë tek gjykatat vendore. Si vijo, ai ka dështuar të përdorë tërësisht mjetet vendore në këtë aspekt ashtu siç kërkohet me Nenin 35 §1 të Konventës dhe se kjo ankesë duhet të refuzohet sipas Nenit 35 § 4 të Konventës.

Për këto arsye, gjykata në mënyrë unanime

Deklaron se aplikacioni është i papranueshëm.

T.L.EARLY Josep CASADEVALL
Sekretar President